

V E N D I M
Nr.1, datë 19.1.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Manol Konomi,	Anëtar i “““
Hilmi Dakli ,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Veli Budo,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 16.1.1995 dhe 19.1.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.5 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE, i përfaqësuar nga Kryetari zoti Ali Spahia dhe Kryetari i Komisionit të Ligeve zoti Halit Shamata.

O B J E K T I

Interpretimi i dispozitave kushtetuese që kanë të bëjnë me imunitetin e Kryetarit dhe Anëtarit të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin e anëtarit Franc Jakova dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të bëjë interpretimin e dispozitave kushtetuese në lidhje me këto çështje :

a) A është Kuvendi Popullor organi kompetent për t’u hequr imunitetin kryetarit dhe anëtarëve të Gjykatës së Kasacionit;

b) Çfarë duhet kuptuar me fjalët “veprime që lidhen me përmbushjen e detyrave të tyre” të paragrafit të tretë të

nenit 6 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”;

c) Cilat janë “veprat e rënda penale të parashikuara posaçërisht me ligj” në kuptim të paragrafit të katërt të po atij neni dhe cili është organi kompetent që të “vërtetojë se është kryer një nga veprat e rënda penale”.

Duke analizuar përmbajtjen e paragrafit të tretë të

nenit 6 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 të sipërpërmendur, i cili përcakton se “anëtarët e Gjykatës së Kasacionit nuk mund të ndalohen, të arrestohen, ose të dënohen për veprimet që lidhen me përmbushjen e detyrave të tyre”, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë sanksionon sigurimin ligjor të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit për të mos u ndjekur penalisht dhe për të mos u dënuar për veprimet që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij ligjore e që janë shprehja e mendimeve dhe dhënia e vendimeve sipas bindjes së tij të brendshme gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore; pra është një dispozitë konkrete në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqtarëve gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Por kjo dispozitë nuk e mbron anëtarin e Gjykatës së Kasacionit nga ndjekja penale dhe dënimi kur ai, duke shpërdoruar detyrën dhe në lidhje me të, kryen vepra penale.

Ndonëse në Ligjin Kushtetues objekt interpretimi, nuk del në mënyrë të shprehur imuniteti i anëtarëve të Gjykatës së Kasacionit, Gjykata Kushtetuese, duke bërë interpretimin logjik të dispozitave të këtij ligji, sidomos të neneve 6, 10 e 14, arrin në konkluzionin se anëtarët e Gjykatës së Kasacionit gëzojnë imunitet.

Neni 10 përcakton se gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë imunitet. Sipas logjikës juridike nuk mund të pranohet që gjyqtarët e shkallëve më të ulta gëzojnë imunitet, ndërsa gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit mos ta gëzojnë atë.

Konkluzioni i sipërm se anëtarët e Gjykatës së Kasacionit gëzojnë imunitet gjen mbështetje edhe në nenin 14, ku përcaktohet se Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij gëzojnë imunitetin dhe të drejtat e parashikuara nga neni 6 i këtij ligji kushtetues për gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit.

Lidhur me përcaktimin se cili organ ka të drejtë të vendosë për heqjen e imunitetit të anëtarit të Gjykatës së Kasacionit, Gjykata Kushtetuese i përmbahet parimit të përgjithshëm se për heqjen e imunitetit të një subjekti të caktuar, kur në ligj nuk është përcaktuar ndryshe, vendos organi që e ka emëruar ose zgjedhur.

Ky parim sanksionohet edhe në nenin 21 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 “Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile”, ku thuhet se gjyqtarët

nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit që i ka zgjedhur ose emëruar.

Paragrafi i fundit i nenit 6 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, përcakton se “Gjyqtari i Gjykatës së Kasacionit mund të lëvizet nga detyra vetëm mbi bazën e një vendimi të arsyetuar të Kuvendit Popullor kur vërtetohet se ka kryer një nga veprat e rënda penale të parashikuara shprehimisht me ligj ose kur është i paaftë mendërisht”. Me këtë dispozitë sanksionohet parimi juridik i patundshmërisë (palëvizshmërisë) së gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit, me përjashtimet që ka përcaktuar vetë ligji kushtetues.

Duke interpretuar këtë dispozitë, Gjykata konkludon se Kuvendi Popullor me vendim të arsyetuar mund të lëvizë nga detyra gjyqtarin e Gjykatës së Kasacionit kur gjyqtari me vendim të formës së prerë të një gjykate kompetente është dënuar me heqje të lirisë për kryerjen e një vepre penale të parashikuar si të tillë nga ligji. Gjyqtari nuk mund të vazhdojë të kryejë detyrën e tij kur ai është dënuar me heqje të lirisë, sepse kjo nuk pajtohet me funksionin dhe figurën morale të gjyqtarit.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 pika 1, 25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri

V E N D O S I:

1. Organi kompetent për heqjen e imunitetit të kryetarit dhe anëtarëve të Gjykatës së Kasacionit është Kuvendi Popullor.

2. Me fjalët “veprime që lidhen me përmbushjen e detyrave të tyre”, paragrafi 3 i nenit 6 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, duhet kuptuar dhënia e mendimeve dhe vendimeve nga gjyqtarët sipas bindjes së tyre të brendshme në zbatim të ligjit gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore.

3. Kuvendi Popullor me vendim të arsyetuar mund të lëvizë nga detyra gjyqtarin e Gjykatës së Kasacionit kur ai është dënuar me heqje të lirisë për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datën 19.1.1995